

**VENDIM Nr. 581, datë 17.7.2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR. 7703, DATË  
11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR, NR. 9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË  
DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR. 7870, DATË 13.10.1994  
“PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 2 të kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 95 130 (nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë.

2. Pikat 1, 2, 6, 7, 9, 10, 11 e 13 të kreut III, ndryshohen si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 5 308 (pesë mijë e treqind e tetë) lekë.

Kontributi minimal mujor sipas degëve të sigurimit të jetë:

	në %	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	57
Dega e sigurimit të barrë-lindjeve	1.4	266
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	4110
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	57
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	171
Sigurimet shëndetësore	3.4	647

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të jetë 7 për qind e pagës minimale mujore, e barabartë me 1 332 (një mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë.

...

6. I vetëpunësuarin, i vetëpunësuarin në ortakëri, i vetëpunësuarin që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2013 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh, të barabartë me 5 708 (pesë mijë e shtatëqind e tetë) lekë në muaj.

I vetëpunësuarin, për pjesëtarët e familjes së tij mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërishit (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2013 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh, të barabartë me 5 708 (pesë mijë e shtatëqind e tetë) lekë në muaj.

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.8.2013 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 23 000 (njëzet e tre mijë) lekë.

...

13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në muaj.”

3. Nënndarja “vi” e shkronjës “a” të pikës 1 të kreut VII, ndryshohet si më poshtë vijon:

“vi) Të dhënat mujore dhe progresive për detyrimet për kontributet e papaguara në afat për çdo subjekt, si dhe për kreditorët për kontribute të paguara më tepër se detyrimi i llogaritur sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë të Financave.”

4. Kreu VIII ndryshohet si më poshtë

vijon: “VIII. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 e 48 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 12 024 (dymbëdhjetë mijë e njëzet e katër) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma e përfitimit për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 8 233 (tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 3 të nenit 27 të pikës 2 të nenit 59 dhe të nenit 60 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes të të ardhurave për barrë-lindje, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesja nuk ka pagë gjatë gjithë muajve të vitit të fundit kalendarik, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12 muaj.

4. Në mbështetje të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuarat në bujqësi, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 8 233 (tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë në muaj.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.8.2013.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

Botuar ne F.Zyrtare 125 / 2013  
Dale nga shtypi me 30.07.2013